



Republika e Kosovës



Komuna- Vushtri

**PLANI I PUNES
SË KUVENDIT KOMUNAL PËR VITIN 2010**

Janar 2010

Pasqyra planit

Parathënie.....	3
Hyrje.....	4
Janar, Shkurt.....	5
Mars, Prill.....	6
Maj.....	7
Qershor.....	8
Korrik.....	9
Shtator, Tetor.....	10
Nëntor, Dhjetor.....	11
Përfundim.....	12

Parathënie

Kuvendi i Komunës është organi më i lartë në komunë dhe zgjidhet drejtëpërdrejt nga qytetarët. Punën dhe aktivitetin e vetë e mbështetë në LVL, Statutin e Komunës dhe akte tjera nënligjore. Siguron kushte të punës për mbajtje të seancave të kuvendit, si dhe pjesëmarrje për qytetarë gjatë seancave. Siguron transparencë të plotë ndaj qytetarëve për të gjitha vendimet dhe aktet, si dhe për çdo gjë që është në interes të qytetarëve. Po ashtu, iu krijon mundësi qytetarëve që përmes formave të ndryshme të jenë pjesëmarrës në vendimmarrje.

Kuvendi i Komunës, nxjerr akte të rëndësishme për komunën siç janë:

- ❖ Statuti i Komunës;
- ❖ Rregullorja e Punës,
- ❖ Rregulloret komunale dhe
- ❖ Çdo akt tjetër të nevojshëm apo të duhur për funksionim normal të komunës.

Përpos këtyre akteve, Kuvendi i Komunës, kryen edhe funksione tjera dhe detyra të padeleguara:

- ❖ Miraton planin vjetor të punës;
- ❖ Themelon komisione sipas ligjit;
- ❖ Merr vendim për krijimin dhe përdorimin e dekoratave dhe titujve të nderit të komunës, në pajtim me ligjin në fuqi;
- ❖ Bënë emërimin, riemërimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve tjera publike;
- ❖ Arritjen e marrëveshjeve ndër komunale dhe brenda komunale;
- ❖ Marrjen e vendimeve për t'u bashkuar me asociacione përfaqësuese të komunave të Republikës së Kosovës dhe përgjegjësi të tjera që kërkohen me ligj etj.

Hyrje

Plani i Punës të Kuvendit Komunal të Vushtrrisë është dokument i mbështetur në LVL, Statutin e Komunës, Rregulloren e Punës të Kuvendit dhe aktet tjera nënligjore. Është i hartuar në bazë të një kornize logjike i cili planifikon etapat e realizimit të punëve dhe detyrave të kuvendit të bazuara në detyrat dhe përgjegjësitë që dalin nga LVL, Statuti dhe aktet tjera nënligjore.

Përmes këtij plani synojmë arritjen e objektivave për vitin 2010, ku Kuvendi Komunal i Vushtrrisë, planifikon t'i mbaj 11 (njëmbëdhjetë) seanca të rregullta, 5 (pesë) prej të cilave në gjashtëmujorin e parë të vitit 2010, në të cilat do të trajtohen të gjitha çështjet që janë në interes të komunës dhe të qytetarëve të Vushtrrisë, e të cilat janë të proceduara sipas akteve në fuqi.

- ❖ Cakton datën e mbajtjes së mbledhjeve të rregullta të kuvendit sipas rregullores së punës së kuvendit;
- ❖ Themelon Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete spasl ligjit;
- ❖ Funksionalizon komitetet e formuara këshillëdhënëse dhe planifikon raportimin e këtyre komiteteve para kuvendit dy herë në vit.
- ❖ Planifikon raportet e rregullta të punës të Kryetarit të Komunës sipas ligjit;
- ❖ Inkorporon planin e tubimeve me qytetar të Kryetarit të Komunës;
- ❖ Miraton buxhetin dhe planet investuese;
- ❖ Miraton çështje të tjera financiare, të cilat janë të rezervuara për kuvendin sipas statutit apo rregullores së punës;
- ❖ Nxjerr rregullore të reja dhe bënë harmonizimin e rregulloreve ekzistuese me ligjet në fuqi;
- ❖ Inkorporon planin e kryetarit për festa shtetërore e kombëtare.
- ❖ Mbikëqyrë, diskuton, analizon dhe vlerëson punën e ekzekutivit;

Janar 2010

- ❖ **Aprovimi i planit vjetor të punës të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë.** Në këtë seancë, Kryesuesi i Kuvendit do të paraqet para deputetëve projektplanin e punës të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2010, i cili do të diskutohet, analizohet dhe plotësohet nga ana e deputetëve;
- ❖ **Themelimi i dy komiteteve obligative sipas LVL.** Po ashtu, në këtë seancë do të formohen dy komitete të përhershme; Komiteti për Politikë e Financa dhe Komiteti për Komunitete;
- ❖ **Aprovimi i organogramit të komunës.**
- ❖ **Trajtimi i çështjeve tjera të procedura për kuvend.**

Shkurt, 2010

- ❖ Raport për situatën ekonomiko-financiare dhe për zbatimin e planeve investuese në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2009 (Kryetari i Komunës).
- ❖ Informatë për pasqyrat financiare për vitin 2009 (Drejtorja për Buxhet, Thesar dhe Financa).
- ❖ Informatë për të hyrat vetanake për muajin Janar 2010 (Drejtorja për Buxhet Thesar dhe Financa).
- ❖ Informatë për përfundimin e gjysmë vjetorit të parë të vitit shkollor 2009/2010 (Drejtorja e Arsimit).
- ❖ Propozim-vendim për mënyrën e llogaritjes së lartësisë së kompensimit për menaxhimin dhe pranbimin teknik të projekteve kapitale; (Drejtorja e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit).
- ❖ Propozin për plotësimin e Rregullores për tarife, gjoba dhe ngarkesa komunale; (Drejtorja e Administratës).
- ❖ Plani i punës së Auditorit të Komunës për vitin 2010.
- ❖ Plani i punës së Drejtorisë për Prokurim Publik për vitin 2010.

Aktivitetet:

- a) 17 shkurti, Dita e Pavarësisë së Kosovës;
- b) Manifestimi mbahet në Sh.K. "Hasan Prishtina" të gjithë deputetet e Kuvendit Komunal të Vushtrrisë do të janë të ftuar.

Mars, 2010

- ❖ Informatë për të hyrat vetanake për shkurt 2010 (Drejtoria për Buxhet Thesar dhe Financa);
- ❖ Propozim – modifikimi dhe harmonizimi me ligj i Rregullores mbi kriteret dhe procedurat për legalizimin e objekteve të ndërtuara pa leje. (Drejtoria e Urbanizimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit).
- ❖ Rikthim në kuvend pas diskutimit publik të propozimit për plotësimin e Rregullores për tarife, gjoba dhe ngarkesa komunale; (Drejtoria e Administratës).

Aktivitetet:

- a) 5,6,7 Marsi, Epopeja e UÇK-së.
- b) 7 Marsi, Dita e Mësuesit.
- c) 8 Marsi Dita e Nënave (nga një dhuratë për deputetet e Kuvendit Komunal të Vushtrisë).
- d) 24 Marsi, përvjetori i fillimit të sulmeve mbi pozicionet serbe.

Prill, 2010

- ❖ Informatë për të hyrat vetanake dhe shpenzimet buxhetore janar-mars 2010 (Drejtoria për buxhet, Thesar dhe Financa).
- ❖ Rikthim në Kuvend pas diskutimit publik i modifikimit dhe harmonizimit me ligj të Rregullores mbi kriteret dhe procedurat për legalizimin e objekteve të ndërtuara pa leje (Drejtoria e Urbanizimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit).
- ❖ Propozim modifikimi dhe harmonizimi me ligj i Rregullores mbi rregullat dhe procedurat për ndërtimin e objekteve, si dhe vendimi për caktimin e kriterëve bazë për ndërrimin e destinimit për përdorimin e hapësirave banesore. (Drejtoria e Urbanizimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit)

Maj, 2010

- ❖ Informatë për të hyrat vetanake për muajin prill 2010 (Drejtoria për Buxhet Thesar dhe Financa).
- ❖ Rikthim në kuvend pas diskutimit publik për modifikim dhe harmonizim me ligj të Rregullores mbi rregullat dhe procedurat për ndërtimin e objekteve, si dhe vendimi për caktimin e kriterëve bazë për ndërrimin e destinimit për përdorimin e hapësirave banesore. (Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit).
- ❖ Propozim modifikimi dhe harmonizimi me ligj i Rregullores për dhënien e tokës ndërtimore në shfrytëzim të përkohshëm për ndërtimin-vendosjen e objekteve të përkohshme. (Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit);
- ❖ Draft-rregullorja për organizimin e punës dhe të mësimit në shkolla fillore të Komunës së Vushtrrisë (Drejtoria Komunale e Arsimit).

Aktivitetet:

- a) 2 Maji, Akademi përkujtomore me rastin e përvjetorit të masakrës së Studimes;
- b) 9 Maji, Akademi me rastin e Ditës së Evropës;
- c) 14,15 Maji, Takimet e Poeteshave Shqiptare;
- d) 22 maji, Akademi përkujtimore;

Qershor, 2010

- ❖ Informatë për të hyrat vetanake për muajin maj 2010 (Drejtoria për Buxhet Thesar dhe Financa);
- ❖ Qarkorja buxhetore 01/2010 (Drejtoria për Buxhet Thesar dhe Financa);
- ❖ Rikthim në Kuvend pas diskutimit publik për modifikim dhe harmonizim me ligj të Rregullores për dhënien e tokës ndërtimore në shfrytëzim të përkohshëm për ndërtimin-vendosjen e objekteve të përkohshme. (Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit).
- ❖ Draft rregullore për organizmin e punës dhe të mësimin në shkollat fillore të Komunës së Vushtrrisë (Drejtoria Komunale e Arsimit);

Aktivitetet:

- a) 17 Qershori, Dita e Çlirimit të Vushtrrisë, deputetet do të jenë të njoftuar me kohë për të gjitha aktivitetet që do të mbahen me rastin e Ditës së Çlirimit të qytetit të Vushtrrisë.
- b) Tubim me qytetar, raport për situatën ekonomiko-financiare dhe për zbatimin e planeve investuese në gjashtëmuorin e parë të vitit 2010 (Kryetari i Komunës, Kryesuesi i Kuvendit, Nënkryetari, drejtorët e drejtorive dhe deputetët)

Korrik, 2010

- ❖ Raport për situatën ekonomiko-financiare dhe për zbatimin e planeve investuese në gjashtëmujorin e parë të vitit 2010 (Kryetari i Komunës);
- ❖ Informatë për të hyrat vetanake dhe shpenzimet për prill – qershor 2010 (Drejtoria për Buxhet Thesar dhe Financa);
- ❖ Informatë për përfundimin e gjysmë vjetorit të dytë të vitit shkollor 2009/2010 (Drejtoria Komunale e Arsimit);
- ❖ Rikthim në Kuvend pas diskutimit publik i draft rregullorës për organizimin e punës dhe të mësimit në shkollat fillore të Komunës së Vushtrrisë (Drejtoria Komunale e Arsimit);
- ❖ Draft-rregullores për organizimin e punës dhe të mësimit në shkollat e mesme të ulëta të Komunës së Vushtrrisë (Drejtoria Komunale e Arsimit);

Aktivitetet:

- a) Manifestim për mërgimtar;

Gusht, 2010

- ❖ Muaj i pushimit veror për kuvendin.

Shtator, 2010

- ❖ Informatë për të hyrat vetanake për muajin korrik dhe gusht 2010.
- ❖ Planifikimi i buxhetit dhe projekteve investuese për vitin 2010 (Drejtoria për Buxhet Thesar dhe Financa)
- ❖ Rikthim në kuvend pas diskutimit publik i draft- rregullores për tatim në pronë për vitin 2011 (Drejtoria për Buxhet Thesar dhe Financa).
- ❖ Informatë për përfundimin e vitit shkollor 2009/2010 dhe përgatitjet për vitin shkollor 2010/2011 (Drejtoria Komunale e Arsimit).
- ❖ Rikthim në Kuvend pas diskutimit publik i draft - rregullores për organizimin e punës dhe të mësimin në shkollat e mesme të ulta të Komunës së Vushtrrisë (Drejtoria Komunale e Arsimit).

Aktivitetet:

- a) 1 Shtatori, Dita e dëshmorëve të kombit në Komunën e Vushtrrisë;
- b) 24-25 Shtator, Ditët e Hasan Prishtinës.
- c) Dëgjimi buxhetor me qytetar për vitin 2010 (Drejtoria për Buxhet Thesar dhe Financa).

Tetor, 2010.

- ❖ Informatë për të hyrat vetanake dhe shpenzimet për korrik-shtator 2010 (Drejtoria për Buxhet Thesar dhe Financa)
- ❖ Draft-rregullorja për organizimin e punës dhe të mësimin në shkollat e mesme të larta të Komunës së Vushtrrisë (Drejtoria Komunale e Arsimit).
- ❖ Propozim modifikim dhe harmonizim me akte normative i Rregullores mbi sistemimin e vendeve të punës (Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenjes Sociale).

Nëntor, 2010

- ❖ Informatë për të hyrat vetanake (Drejtoria për Buxhet Thesar dhe Financa);
- ❖ Rikthim në Kuvend pas diskutimit publik i draft-regullores për organizimin e punës dhe të mësimit në shkollat e mesme të larta të Komunës së vushtrrisë (Drejtoria Komunale e Arsimit);
- ❖ Rikthim në Kuvend pas diskutimit publik të propozimit për modifikim dhe harmonizim me akte normative të Rregullores mbi sistemimin e vendeve të punës (Drejtoria e Shëndetësisë dhe e Mirëqenjes Sociale);

Aktivitetet:

- a) 28 Nëntori, Dita e Flamurit.

Dhjetor, 2010

- ❖ Raport për situatën ekonomiko-financiare dhe për zbatimin e planeve investuese në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2010 (Kryetari i Komunës).
- ❖ Informatë për të hyrat vetanake për majin, nëntor 2010.
- ❖ Propozimi për ndryshimin e rregullores për tarifa dhe ngarkesa komunale (Drejtoria për Buxhet Thesar dhe Financa)
- ❖ Tubimi publik me qytetarë (Kryetari i Komunës).

Përfundim

Plani vjetor i punës të Kuvendit Komunal të Vushtrrisë, do të ndihmoj dhe lehtësoi punimet e seancave të kuvendit. Duke iu ofruar delegatëve planin e punës, ata do të kenë një pasqyrë për të gjitha punët dhe aktivitetet për vitin 2010.

Edhe pse në planin e punës janë parapa 11 seanca të rregullta, sipas nevojës, mund të mbahen edhe seanca të jashtëzakonshme konform LVL.

Vushtrri, janar 2010

Kryesuesi i Kuvendit
Ferit Idrizi